



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Zyra për Planifikim Strategjik - Kancelarija za strateško planiranje - Strategic Planning Office

PLANI VJETOR I DOKUMENTEVE STRATEGJIKE PËR PERIUdhËN 2019-2021

Zyra për Planifikim Strategjik duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit ka hartuar Planin Vjetor të Dokumenteve Strategjike (PVDS) për periudhën 2019-2021, i cili është miratuar si pjesë e Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2019.

Ashtu siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ 07/2018, Plani Vjetor i Dokumenteve Strategjike përmban vetëm ato dokumente që do të zgjidhin probleme të rëndësishme dhe që do të mbështesin zbatimin e prioritetëve të Qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe procesit të Integritimit Evropian. Duhet theksuar se asnjë institucion nuk mund të fillojë hartimin e një dokumenti strategjik në qoftë se dokumenti strategjik nuk është përfshirë në PVDS dhe PVPQ. Kjo po ashtu vlen edhe për çdo ndryshim dhe rishikim të dokumenteve strategjike ekzistuese dhe planeve të tyre të veprimit.

Plani Vjetor i Dokumenteve Strategjike për periudhën 2019-2021, përfshinë 17 dokumente strategjike për vitin 2019, 6 dokumente strategjike për vitin 2020 dhe 2 dokumente strategjike për vitin 2021. Dokumentet strategjike të përfshira në listë dhe të cilat janë konsultuar me Ministrinë e linjës përfshijnë si në vijim:

- Propozime për dokumente strategjike të reja, duke përfshirë propozime të ZPS-së për shkrirjen/integrimin e çështjeve të përbashkëta;
- Dokumente të cilat kanë filluar të hartohen gjatë vitit 2018, dhe për shkak të vonesave barten në vitin 2019; dhe
- Dokumente strategjike ekzistuese që i kalon periudha e zbatimit dhe propozohen për rishikim.

Në fund, të gjitha dokumentet strategjike dhe planet e veprimit duhet të hartohen në pajtim të plotë me Udhëzimin Administrativ 07/2018 si dhe të mbështeten në udhëzimet e dhëna në Manualin për planifikimin hartimin dhe monitorimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre të veprimit.

PVDS 2019-2021

Nr	Titulli i dokumentit strategjik	Sektorët/ nën-sektorët që do të mbulohen	Ministrinë udhëheqëse	Ministrinë e përfshira	Ndërlidhja me dokumentet strategjike	Data indikative e miratimit		
						2019	2020	2021
1	Rishikimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim	Rritja ekonomike dhe përmirësimi i konkurrueshmërisë	ZKM	Ministrinë e linjës		K3		
2	Strategjia për Specializimin e Mençur	Arsimi, tregtia dhe industria, inovacioni	ZKM	MIN, MASHT, MTI, MZHE	SKZH, PKZMSA		K4	
3	Strategjia për përmirësimin e zhvillimit, koordinimit dhe komunikimit të politikave	Reforma e Administratës Publike	ZKM	MF, MIE, MAP	PKZMSA			K4
4	Strategjia e Sigurisë së Kosovës	Siguria dhe mbrojtja	ZKM, MFSK	MFSK, MPB, institucionet	Rishikimi strategjik i	K4		

				tjera të sigurisë	sektorit të sigurisë			
5	Strategjia për të drejtat e njeriut	Të Drejtat e Njeriut	ZKM	Ministritë e linjës	PKZMSA	K3		
6	Strategjia për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre	Të drejtat e minoriteteve	ZKM, MKK	Ministritë e linjës	PKMZSA	K4		
7	Strategjia për luftimin e ekonomisë jo-formale	Siguria, financat	MF	ZKM, MPB, MPMS	PKZMSA, PRE	K4		
8	Rishikimi i Strategjisë për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike	Menaxhimi i financave publike	MF	ZKM, MAP, DK, KRPP, etj.	PKZMSA,			
9	Strategjia e Migrimit	Punët e brendshme	MPB	ZKM, MPMS, ASK, MSH	PKZMSA	K3		
10	Strategjia për menaxhimin e integruar të kufirit	Punët e brendshme	MPB	PK, Dogana, AUV	PKZMSA	K4		
11	Rishikimi i Strategjisë Sektoriale dhe Transportit Multimodal dhe Plani i Veprimit 5 vjeçar	Transporti	MI	MF, ZKM, MMPH	SKZH, PKZMSA,	K4		
12	Strategjia për zhvillimin e sektorit privat	Tregtia dhe industria	MTI	MF, ZKM, Doganat, etj.	SKZH, PKZMSA	K2		
13	Strategjia për sektorin turizmit	Tregtia dhe industria	MTI	MMPH, MKRS, MBPZHR	PRE, PKZMSA		K2	
14	Strategjia për politikën e jashtme	Politika e jashtme	MPJ	ZKM, MIE, MF, MTI, MDIS	Programi i Qeverisë	K2		
15	Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	Bujqësia dhe zhvillimi rural	MBPZHR		SKZH, Programi i Qeverisë, PKZMSA		K3	
16	Strategjia për Zhvillimin e	Bujqësia dhe	MBPZHR		SKZH, Programi			

	Pylltarisë	zhvillimi rural			i Qeverisë	K3		
17	Strategjia sektoriale e sundimit të ligjit	Drejhtësia dhe punët e brendshme	MD	MPB, KGJK, KPK	PKZMSA		K2	
18	Strategjia dixhitale e Kosovës	TIK	MZHE		PKZMSA, SKZH		K4	
19	Programi për zbatimin e Strategjisë Minerare të Kosovës	Energji dhe miniera	MZHE		PKZMSA, SKZH, Programi i Qeverisë			K3
20	Strategjia për menaxhimin e integruar të mbeturinave në Kosovë	Mjedisi	MMPH	MZHE, Komunat	SKZH, Programi i Qeverisë	K3		
21	Strategjia për Mbrojtje të mjedisit dhe Zhvillim të qëndrueshëm	Mjedisi	MMPH		PKZMSA, Programi i Qeverisë, SKZH		K4	
22	Strategjia e Kosovës për Sport	Sporti, zhvillimi i rinisë	MKRS			K3		
23	Strategjia Kombëtare për Kulturë	Kultura	MKRS			K3		
24	Strategjia për Inovacion dhe Ndërmarrësi	Ndërmarrësia & Inovacioni	MIN, MASHT, MTI		Programi i Qeverisë	K2		
25	Strategjia për Zhvillim Rajonal	Zhvillimi Rajonal	MZHR		Programi i Qeverisë	K4		